



**ODA E STOMATOLOGËVE
TË KOSOVËS**



**SHOQATA E TË DREJTAVE TË PACIENTËVE
NË KOSOVË- PRAK**



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MIDIS
ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS DHE
SHOQATËS SË TË DREJTAVE TË PACIENTËVE NË KOSOVË**

Palët në këtë memorandum:

ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (në vazhdim nën akronim OSK) me seli në adresë Rr. Kosta Novaković p.n. Kontenieri III, zyra nr. 214, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i OSK-së, Prof .Dr. Blerim Kamberi

dhe

SHOQATA E TË DREJTAVE TË PACIENTËVE NË KOSOVË (në vazhdim nën akronim PRAK) me seli në adresë Rr. 11 Marsi, Lam 3B, nr. 2 në Prizren, Republika e Kosovës, nga përfaqësuesi i autorizuar, Z. Besim Kodra.

Me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellët për të siguruar avansimin e raporteve në mes të Stomatologëve si profesionist shëndetësor dhe pacientëve si shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore;

Përmes bashkëpunimit të ndërsjellët në mbrojtje të integritetit të pacientit dhe stomatologut në marrëdhënie shoqërore në fushën shëndetësore;

Në mbrojtje të vlerave profesionale dhe integritetit të pozitës shoqërore të stomatologut si profesionist shëndetësor;

Me qëllim të promovimit të parimeve të deontologjisë mjekësore për trajtimin e dinjitetshëm të pacientit si e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme;

Me angazhim për të dhënë kontributin në forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve të vendit;

Për veprime konkrete institucionale për avansimin e kushteve në vendin e punës dhe trajtimit të dinjitetshëm në marrëdhënie të punës;

Me ndërveprim për të mirën e pacientit dhe respektim të protokollit mjekësor, etikës dhe deontologjisë mjekësore;

Palët në këtë memorandum dakordohen si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

1. Ky Memorandum synon zhvillimin e bashkëpunimit të ngushtë, duke u bazuar në funksionet publike funksionale dhe shoqërore të palëve.
2. Memorandumi ka për qëllim veçanërisht që të ngritë nivelin e bashkëpunimit të palëve duke marrë parasysh natyrën e veprimtarisë dhe aktiviteteve përkitazi me raportin e dyanshëm në mes të mjekut stomatolog dhe pacientit.

Neni 2 Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet të përdorura, në kuptimin e këtij Memorandumi kanë këtë domethënie:
 - 1.1 **Nivelet e kujdesit shëndetësor** - nënkupton tri nivelet e sistemit shëndetësor duke përfshirë nivelin parësor, dytësor dhe tretësor;
 - 1.2 **Të drejtat e pacientëve** – nënkupton të drejtat të garantuara me legjislacionin në fushën e shëndetësisë që është në fuqi dhe akteve me karakter universal ndërkombëtar;
 - 1.3 **Ministria** - Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4 **Fushëveprimi dhe veprimtaria** – nënkupton veprimtarinë e palëve të cilën e ushtrojnë sipas autorizimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Neni 3 Parimet themelore të bashkëpunimit

1. Zotimet e marra me këtë memorandum palët do të kujdesen që t'i zbatojnë në kauzën e këtij

memorandumi duke marrë parasysh parimet e mëposhtme:

- 1.1. Dinjitetit dhe integritetit i pacientit dhe stomatologut në shërbim shëndetësor si dy akterë me rëndësi të posaçme sociale;
- 1.2. Puna korrekte e stomatologut ka një rëndësi të veçantë ndaj pacientëve dhe publikut;
- 1.3. Sistemet moderne shëndetësore janë ngritur me konceptin e “pacientit në qendër të Sistemit Shëndetësorë”;
- 1.4. Pacienti duhet të jetë pjesë aktive e vendimeve që kanë të bëjnë me të;
- 1.5. Palët janë pjesë integrale të njëra – tjetrës; dhe
- 1.6. Vlerësimi i profesionit fisnik të mjekut dhe mbrojtja e integritetit profesional.

2. Palët në këtë memorandum gjithashtu shprehin pajtimin parimor se:

- 2.1. Shëndetësia është nevojë dhe domosdoshmëri shoqërore dhe duhet të mbrohet nga të gjithë akterët të Sistemit Shëndetësorë;
- 2.2. Të dy palët janë pjesa më e rëndësishme e Sistemit Shëndetësorë;
- 2.3. Pa mbrojtjen e dinjitetshme të të dyja palëve, forcimi dhe progresi në sistemin shëndetësor janë të paarritshëm;
- 2.4. Vullnetin e palëve dhe angazhimin maksimal për të siguruar dhe zbatuar të gjitha mjetet e nevojshme në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore;
- 2.5. Vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksionimin dhe realizimin e këtij memorandum në parimet dhe kushtet e cekura në këtë memorandum.
- 2.6. Duke u udhëhequr në autorizimet dhe të drejtat e shprehura në Ligjin për Odat e Professionistëve Shëndetësorë dhe Kartën e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë.

Neni 4 **Fusha e bashkëpunimit**

1. Palët dakordohen që të angazhohen për nevojat e veprimtarisë së tyre në këto çështje:

- 1.1 PRAK t'i ketë përfaqësuesit e vet në cilësinë e vëzhguesit nëpër organe të OSK – së ku vendimmarrja ka të bëjë me të drejtat e pacientëve;
- 1.2 Personi i autorizuar për komunikim zyrtar i OSK-së do ta njoftojë në mënyrë zyrtare siç është paraparë me këtë memorandum PRAK-un për mbledhje të organeve ku do të diskutohet për të drejtat e pacientëve dhe t'i ofrojë materialet e nevojshme për trajtimin e çështjes që është në interes;

- 1.3 PRAK pajtohet që të ketë një angazhim konstruktiv duke mos cenuar punën normale të Odës dhe duke ruajtur konfidencialitetin e dokumenteve të mbyllura për publikun;
- 1.4 Për çdo trajtim të rastit konkret PRAK-u do të përmbahet nga çfarëdo prononcimi paragjykes pa përfunduar procedura me vendim të formës së prerë;
- 1.5 PRAK pajtohet që të kontribuoj në avancimin e punës së organeve të OSK;
- 1.6 PRAK dhe OSK do të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta me qëllim të promovimit të të drejtave dhe obligimeve të palëve në një mardhënje mjek – pacient;
- 1.7 PRAK dhe OSK do të angazhohen në mbrojtje të Kodit të Etikës Mjekësore dhe dokumenteve të tjera që ndërlidhen me etikën.
- 1.8 PRAK brenda fushëveprimit publik do të angazhohet për promovimin e vlerës shoqërore dhe humane të profesionit të stomatologut në shoqëri;
- 1.9 Palët do të shkëmbejnë informacione që janë në dobi të avancimit të punës së mjekut dhe të drejtës së pacientit;
- 1.10 Palët bashkarishtë do të ndërmarrin veprime për të rregulluar segmente të caktuara të dhënies së shërbimit shëndetësorë brenda kuadrit ligjor.

Neni 5 Metodologjia e bashkëpunimit

1. Me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të ndërsjellët, palët dakordohen që bashkëpunimin e përcaktuar në nenin 4 të këtij memorandumi ta realizojnë përmes:
 - 1.1 Takimeve të thirrura nga cilado palë në bazë të nevojës në mes të përfaqësuesve të OSK-së dhe përfaqësuesve të PRAK-ut;
 - 1.2 Themelimi i grupeve punuese për përpilimin e dokumenteve të ndryshme strategjike dhe operative që kanë të bëjnë me implementimin e dakordimit nga Neni 4 i këtij memorandum; dhe
 - 1.3 Bashkëpunimi për nismat e përbashkëta për realizimin e projekteve specifike në fushë veprimtarinë e palëve.
2. Për çfarëdo nevoje lidhur me praktikën e bashkëpunimit, palët në këtë memorandum do të bashkërendojnë veprimet e tyre me qëllim të arritjes së objektivave të shprehura në këtë memorandum.

Neni 6 Mënyra e komunikimit

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'i komunikojnë zyrtarët e tyre për komunikim përmes shkresës zyrtare të autorizuar nga organi kompetent i palës.

2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejta si dhe përmes komunikimit formal përmes postës dhe komunikimit elektronik.

3. Adresat zyrtare të komunikimit janë:

3.1 Oda e Stomatologëve të Kosovës(OSK) - E-mail: info@osk-ks.org, nr. tel. 045/240588 .

3.2 Shoqata e të drejtave të pacientëve në Kosovë – E-mail info@prak-kosova.org, nr. tel + 383 49 946 201.

Neni 7 Kohëzgjatja e memorandumit

Ky memorandum lidhen në afat të pacaktuar.. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandumi.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

Neni 9 Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.
2. Ky memorandum është lidhur në gjuhën shqipe dhe atë në 2 (dy) ekzemplar identik, nga 1 (një) për secilën palë.

Prishtinë, 25.07.2019

Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Prof. Dr. Blerim Kamberi



Për Shoqatën e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë

Z. Besim Kodra

